



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.6/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit: Komisioni i Pavarur për Miniera e Minerale me adresë Rr. Armend Daci nr.1-Prishtinë, kundër debitorit: “A...” SH.P.K me numër regjistrimi të biznesit ... me seli në, Komuna e Kamenicës të cilën e përfaqëson V.S. me numër personal, që ka të bëjë me pagesën e borxhit, si objekt i përmbartimit, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të ushtruar kundër Urdhrit të Përmbartuesja Private Sefer Sh. Arifi P.nr.415/2017 të dt:23.10.2017, mbi caktimin e përmbartimit, me dt:05.09.2022, jashtë seance merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET SI I PABAZUAR prapësimi i debitorit: “A...” SH.P.K me numër regjistrimi të biznesit ... me seli në, Komuna e Kamenicës të cilën e përfaqëson V.S. me numër personal, i ushtruar kundër Urdhrit për lejimin e përmbartimit numër P.nr.415/2017 të dt:23.10.2017, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Sefer Sh. Arifi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi privat Sefer Sh. Arifi me seli të zyrës në Gjilan, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të Aktvendimit të Komisionit për Miniera dhe Minerale me numër 3552 të datës 16.12.2014 dhe aktvendimit me numër nr.3607 të datës 22.12.2014, të cilët janë dokumente përmbartuese në bazë të nenit 21 dhe 22 të LPP-së.

Kundër urdhrit për lejimin e përmbartimit, brenda afatit ligjor, prapësim ka paraqitur debitori. Në prapësim ka theksuar se Përmbartuesi privat ka lejuar propozimin për përmbartim dhe urdhrin përmbartimor në kundërshtim me dispozitat ligjore, kështu që debitori pretendon se përmbartuesi privat ka bërë shekeje esenciale të procedurës përmbartimore, konkretisht nenit 49 të LPP-së ngase ka kaluar kufijtë e përmbartimit. Po ashtu debitori ka theksuar se me nenin 38 të LPP-së shprehimisht është paraparë se citoj; “ *Propozimi për përmbartim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbartimi, kërkuesi i përmbartimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbartimi, objekti i përmbartimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbartimit.* Pra urdhri përmbartimor në rastin nuk është caktuar brenda kufijve të përmbartimit siç është përcaktuar me aktvendimet 3552 të datës 16.12.2014 dhe 3607 të datës 22.12.2014, por i njëjti është drejtuar ndaj V.S. dhe J.S. si pronar të Kompanisë A....sh.p.k.

Debitori i përmbarimit ka theksuar se nëse analizoj dokumentin përmbarimor aktvendimet mbi bazën e të cilit është lëshuar urdhri përmbarimor atëherë vijnë në përfundim se titulli përmbarimor drejtohet ndaj tjetër kujt në cilësinë e debitorit ndërsa propozimi për përmbarim drejtohet ndaj kompanisë A... Sh.p.k e cila nuk ka legjitimitet për të qenë debitor në këtë procedurë përmbarimore. Gjithashtu debitori në prapsim ka theksuar se kreditori në propozimin për përmbarim është deshtë të paraqet Aktvendimet me të cilat ishte refuzuar ankesa e debitorit.

Nga kjo që është theksuar me lartë debitori i përmbarimit i kishte propozuar Gjykatës që të refuzohet propozimin si i pa bazuar dhe të shfuqizohet urdhri përmbarimor.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësimin e debitorit, ka theksuar se pretendimet e debitorit se gjoja janë shkelur dispozitat e LPP-së përkatësisht neni 49 i këtij ligji, ky pretendim është i pa qëndrueshëm dhe nuk ka bazë ligjore për faktin se urdhri përmbarimor është lejuar konform dokumenteve përmbarimore Aktvendimeve nr.3552 dhe 3607 ku në këto vendime figuron emri i debitorit V.S. si pronar i Kompanisë A... Sh.p.k me numër të NRB ... me adresë në ... Komuna e Kamenicës dhe se përgjegjësia për të paguar gjobën në rastin konkret nuk mund t'i adresohet personave apo debitorëve dhe pronarëve të cilët nuk ceken me propozim për përmbarim meqë aktvendimi si objekt i këtij përmbarimi në dispozitivin e tij parasheh se cilët subjekte janë obliguar për pagesën e kësaj gjobe. Kreditori po ashtu ka theksuar se dokumente përmbarimore lejuar konform dispozitave të LPP-së, konkretisht neni 36 të këtij ligji ngase dokument e lartcekura përmbaj klauzolën e plotfuqishmërisë dhe të ekzekutueshmërisë dhe si të tilla i përmbushin të gjitha kriteret e parapara me LPP-në.

Prandaj duke pasur parasysh të gjitha të lartpërmendurat, kreditori i përmbarimit i kishte propozuar gjykatës që prapsmin e debitorit të refuzoj në tersi si të pa bazuar.

Gjykata, fillimisht vlerësoi legjitimitetin e palëve në procedurë meqë ishte pretendim i debitorit, e njëjta vlerësoi se urdhri përmbarimor i lejuar nga Përmbaruesi Privat ishte në harmoni me dokumente përmbarimore ngase me aktvendimin me numër 3552 të datës 16.12.2014 dhe aktvendimin nr.3607 të datës 22.12.2014 me të cilët ishte shqiptuar gjobë pronarëve të kompanisë në kuadër të veprimtarisë që ushtron Kompani A... shpk me numër të biznesit ..., andaj mbi këtë bazë Kompania në fjalë e ka legjitimitetin e plotë për të qenë debitorë e përmbarimit në këtë procedurë. Këtë fakt gjykata e vërteton në ARBK në të cilën përcaktohet statuti dhe veprimtari e saj, andaj në vlerësimin e gjykatës urdhri përmbarimor ishte lejuar ndaj Kompanisë duke pasur parasysh se Kompani është regjistruar si Sh.p.k dhe e njëjta është detyruar që të paguaj gjobat e shqiptuara sipas titullit përmbarimore, kjo për faktin se në Ligjin për Shoqëritë Tregtare është e përcaktuar se Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar janë përgjegjëse për të gjitha borxhet e saj dhe detyrimet tjera me të gjitha asetet e saj. Po ashtu në të njëjtin ligj përcaktohet se aksionar i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar nuk është përgjegjës për borxhet ose detyrimet e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar vetëm për arsye se është aksionar. Pra në rastin konkret kemi të bëjmë me një gjobë të shqiptuar ndaj pronarit të Sh.p.k në kuadër të veprimtarisë së saj, andaj kjo përgjegjësi për pagesën e detyrimit bie në Kompaninë A.... Sh.p.k, prandaj sa i përket legjitimiteti të palëve në këtë procedurë përmbarimore pretendimi i debitorit është i pa qëndrueshëm dhe i pa bazuar në ligj.

Në rastin konkret gjykata ka bërë vlerësimin e shkresa të lëndës, ka konsideruar se pretendimet lartpërmendura të debitorit nuk janë të qëndrueshme dhe të bazuara në ligj, për arsyes se gjykata përmbarimore nuk ka tagër të vlerësoj kompetencat ligjore apo tejkalimin e tyre, përmbytjen e një vendimi të formës së prere dhe të ekzekutueshëm nga një Organ tjetër siç është në këtë rast Komisionit për Miniera dhe Minerale, por kompetencë e gjykatës përmbarimore në këtë rast është përmbarimi i vendimit të tillë si dokument përmbarues, ndërsa për vlefshmërinë e këtij akti të cilën debitori e konteston, këtë mund të kërkoj në procedura tjera.

Gjykata e shkallës së parë për prapësimin e debitorit ka theksuar se nuk mund të vlerësoi Aktvendimet Administrative të Komisionit për Miniera dhe Minerale me numër 3552 të datës 16.12.2014 dhe numër 3607 të datës 22.12.2014, në aspektin e ligjshmërisë, por është bërë vlerësimi i aktvendimeve në fjalë lidhur me kriteret që kanë të bëjë me përmbarushmërinë e tyre. Gjykata ka zbatuar përmbarimin, në bazë të vendimeve të Komisionit për Miniera dhe Minerale, sepse një vendim i tillë është dokument përmbarues, pra përbën bazën juridike për caktimin e përmbarimit, ngase i kanë plotësuar kushtet ligjore nga neni 24 par.3 dhe neni 27 të LPP-së, për të qen i përmbarueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbarim.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.6/22, dt.05.09.2022

Gj y q t a r i
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.